Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

1. Kuptimi i termave

Termat e përdorura në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorura në Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, në Termat e Referencës (shtojca 12), si dhe legjislacionin shqiptar për mbetjet në nenin 3, të Ligjit Nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" të ndryshuar, VKM Nr. 418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim" dhe VKM 608, datë 17.09.2015, "Për Masat e Nevojshme për Grumbullimin dhe Trajtimin e Mbetjeve Bio si dhe Kriteret dhe Afatet për Pakësimin e tyre", si dhe ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

2. Qëllimi i Specifikimeve Teknike

Këto Specifikime teknike synojnë që të saktësojnë kërkesat e NSHK Durrës, Bashkia Durrës në vijim Autoritetit Kontraktues, në lidhje me qëllimin e Kontratës për Shërbim i Pastrimit të Njesise Administrative Ishem të shërbimit (sic specifikohet më poshtë), në sasinë dhe cilësinë dhe shpërndarjen e këtij shërbimi të përcaktuara në Termat e Referencës dhe në hartat bashkëlidhur (Shtojca 12).

3. Skicimet, parametrat teknik etj:

3.1 Zona e Shërbimit

1. Shërbimi mbulon territorin e Njesise Administrative Ishem (harta bashkëlidhur). Numri i përgjithshëm i banorëve rezident të njesise është vlerësuar rreth 9.231 banorë rezidente në sezonin e Shtator – Maj, te ciles i shtohen edhe rreth 150.000 persona për cdo ditë në sezonin turistik Qershor – Gusht vecanërisht në zonën e bregdetit (vertetuar me vertetim te leshuar nga Njesia Administrative Ishem me nr. 1184/1 prot date 26.11.2020).

NJESIA ADMINISTRATIVE ISHEM



2. Gjithsej do te behet pastrimi i 120 pika VMM (vend i mbajtjes se mbeturinave) te mbetjeve urbane te shperndara ne te gjithe territorin e Njesise Administrative Ishem , sipas hartave treguese me emrat e fshatrave dhe zonave te poshteshenuara. (harta bashkëlidhur)


SHETAJ

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




SHENPJETER

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




LALEZ

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




GJYRICAJ

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE




DRAC

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE



BIZE

PLAN VENDOSJA SH.1:5000 PIKAT E GRUMBULLIMIT TE MBETJEVE URBANE



3. Numri i kazaneve per cdo VMM eshte ne varesi te sasise se mbetjeve dhe frekuences se evadimit, ku ne total duhen rreth 220 kazane 1100 litra, te shperndara ne 120 pikat e VMM-ve.

a) Kontenieret duhet te jene me 4 rrota dhe kapak të shështë ose më kapak të rrumbullakosur. Në të dy rastet kapaku duhet të jetë lehtësisht i lëvizshem për të mundësuar hedhjen e

mbeturinave nga konsumatorët si dhe hapjen e tyre për shkarkimin në kamion. Nuk do të pranohen dhe nuk do të lejohet të përdoren kontenierë pa kapak dhe pa rrota. Kontenieri do të ketë dorëza anësore në të dy anët për të mundësuar lëvizjen drejt dhe për nga kamioni në Vend Mbajtja e Mbetjeve (VMM), si dhe boshtin të të dy krahët për kapjen dhe ngritjen nëpërmjet mekanizmit të ngritjes për shkarkimin e mbetjeve në kamion.

- b) Të gjithë kontenierët e përdorur për zbatimin e kontratës duhet të mbahen të pastër, në gjëndje të mirë teknike. Në rast dëmtimesh, djegie, deformimesh të kontenierëve, si dhe dëmtime rrotash dhe kapakësh, të cilat çojnë në mosfunksionimin e plote teknik, higjenik dhe estetik të tij gjatë kohëzgjatjes së kontratës si dhe mungesës së kontenierëve, operatori i shërbimit ka përgjegjësinë për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe riparimin e kontenierëve për çdo rast dhe për çdo shkak. Operatori i shërbimit merr përsipër riparimin e të gjitha dëmtimeve dhe sigurimin e pjesëve të këmbimit. Operatori do të riparojë ose zëvendësojë kontenierët brenda 15 ditëve nga momenti i konstatimit të dëmtimit dhe/ose njoftimit nga Autoriteti Kontraktor për dëmtimin e kontenierëve. Në rast të mosriparimit të plotë të kontenierëve ose mos zëvendësimit të tyre kur janë të riparueshëm, ndaj operatorit të shërbimit aplikohen penaltete sipas Nenit perkates "Penaltete dhe Ndalesa" në kushtet e përgjithshme të kontratës.
- c) Kontenierët do të pajisen nga Operatori në të katër cepat me flete vetengjitesë (adezive) fosforeshent, me vija të bardha dhe të kuqe për tu bërë të dallueshëm gjatë natës nga mjetet dhe njerëzit që qarkullojnë në rruget ku janë vendosur në pikat e grumbullimit.
- d) Të gjitha Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve duhet të identifikohen sipas numrit respektiv të pikës, që duhet të jetë lehtësisht i dukshëm për komunitetin. Operatori i shërbimit mund të vendosë dukshëm numrat e VMM-ve mbi njërin nga kontenieret apo ambjentetë tjera rreth pikës sipas "Listës së pikave dhe vendodhjes së tyre".

4. Frekuenca e evadimit të mbetjeve do të jete nje here ne 24 ore.

5. Disinfektimi dhe klorifikimi (sipas termave të referencës) i kazanëve dhe i hapësirës 5m² përreth tyre do të kryhet çdo ditë, pas evadimit të mbetjeve nga kazanet duke përdorur autobotin e ujit. Me elementin e dezinfektimit kuptojmë realizimin e shërbimit të dezinfektimit dhe deratizimit të të gjithë sipërfaqes së jashtme dhe të brendshme të kontenierit. Ky shërbim do të kryhet detyruesisht mbasi të jetë bërë zbrazja dhe pastrimi i kontenierëve të mbledhjes së mbeturinave urbane etj.

6. Pastrimi i Njesisë Administrative Ishem që përfshin: Fshirje, Krehje dhe Grruerje (sipas termave të referencës) do të kryhen në mënyrë të alternuar një herë çdo 2 ditë.

7. Raportet dhe Statistikat

Operatori duhet të mbajë statistika të përditshme mbi pikat kryesore të mëposhtme dhe ti raportojë supervizorit çdo muaj, në format zyrtar letër dhe në formë dixhitale:

- numri i kontenierëve të ngarkuar në çdo rrugë
- orët reale të mbledhjes: ora e nisjes së kamionëve, koha e shkarkimit në landfill, koha e kthimit në garazh/parkim
- sasinë për çdo grumbullim të mbetjeve (ton /grumbullim) që shkarkohen në VGM.
- km rrugë që përshkohen çdo ditë nga çdo kamion për grumbullimin e mbetjeve
- konsumi i naftës dhe i vajit për çdo kamion, operacionet e mirëmbajtjes dhe data
- numri dhe itinerari i rrugëve që ndjekin kamionët
- lista e të punësuarve dhe orëve të punës

-
- h) inventari mujor i kontenierëve, rrugë për rrugë, me numër identifikimi dhe gjendjen fizike
 - i) zhvendosjen, mirëmbajtjen ose zhdukjen e kontenierëve, larjen e tyre: lista e kontenierëve (rruge, numri i identifikimit), riparime specifike dhe data
 - j) Informacion mbi kërkesën e supervizorit për mangësinë në cilësi ose sasinë e shërbimit;

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to: Sipas termave të referencës.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Pastrimi dhe evadimi i mbetjeve urbane ne Njesine Administrative Ishem duke perfshire te gjitha zonat e njesise te percaktuara ne hartën treguese bashkangjitur.

Detyrat:

Pastrimi, ne teresi si proces ,perfshin ne vetvete disa procese sic jane : krehja, gerryerja, fshirja, dhe mirembajtja e sipërfaqeve te banuara dhe ne fund evadimi i mbetjeve urbane .

Keto procese, kryen ne te gjitha zonat e banuara te shtrira ne 8 fshatra, duke perfshire dhe vijen bregdetare me evadimin e mbetjeve.

-Fshirja kosiston ne fshirjen e qendres se njesise, duke perfshire rruget, trotuaret, vmm, kuartallat ose hapsirat midis pallateve.

-Krehja, perfshin grumbullimin e cdo lloj mbetje, ne te gjithe teritorin e njesise, duke perfshire rruget, kuartallat dhe vijen bregdetare.

-Gerryerja, presupozon gerryerjen e kunetave te rrugeve, dhe vendeve te tjera ku krijohen depozitime dherash.

-Te gjitha proceset e mesiperme nuk kryen per cdo dite, mbasi nuk mundet te mbulohet gjithe sipërfaqja me fuqi puntore, por keto mirembahen ne menyre te alteruar njehere ne 2 dite.

Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve urbane do te realizohet cdo dit nen kontrollin e drejtorit teknik te caktuar nga operatori.

Mbas perfundimit te proceseve te pastrimit, kryet dhe procesi me kryesor ai i evadimit te mbetjeve urbane, i cili kryet me nje grafik te vecante, ne varesi te sasise se mbetjeve qe gjenerohen.

Kontenieret e mbetjeve urbane do te lahen me uje me nje frekuecen nje here ne jave.

Desinfektimi dhe klorifikimi i kazaneve do te behet cdo dit pas evadimit te mbetjeve nga kazanet duke perdorur klor leng per kazanet dhe gelqere pluhur plus klor pluhur ne masen 5% per dezinfektimin e hapësire 5m2 perreth kazanit te mbetjeve.

Operatori duhet te mbaje statistika të përditshme mbi pikat kryesore të mëposhtme dhe ti raportojë supervizorit çdo muaj, ne format zyrtar letër dhe ne forme dixhitale:

1. numri i kontenierëve të ngarkuar në çdo rrugë

-
2. orët reale të mbledhjes: ora e nisjes së kamionëve, koha e shkarkimit në landfill, koha e kthimit në garazh/parkim
 3. koha e shkarkimit në Stacionin e Transferimit,
 4. sasinë për çdo grumbullim të mbetjeve të riciklueshme (ton /grumbullim) që shkarkohen në Stacionin e Transferimit;
 5. sasinë e fraksioneve të riciklueshme (ton/grumbullim) të selektuara dhe të përgatitura për shitje nga Operatori në këtë Stacion, si dhe
 6. sasinë e mbetjeve të pariciklueshme që rezultojnë nga procesi i selektimit dhe që transportohen në landfill,
 7. km rrugë që përshkohen çdo ditë nga çdo kamion për grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme dhe të pariciklueshme
 8. konsumi i naftës dhe i vajit për çdo kamion, operacionet e mirëmbajtjes dhe data
 9. numri dhe itinerari i rrugëve që ndjekin kamionët
 10. lista e të punësuarve dhe orëve të punës
 11. inventari mujor i kontenerëve, rrugë për rrugë, me numër identifikimi dhe gjendjen fizike
 12. zhvendosjen, mirëmbajtjen ose zhdukjen e kontenerëve, larjen e tyre: lista e kontenerëve (rruge, numri i identifikimit), riparime specifike dhe data
 13. Informacion mbi kërkesën e të dërguarit të bashkisë ose supervizorit për mangësinë në cilësi ose sasinë e shërbimit;

Shpërndarja:

Njesia Administrative Ishem, ka një vijë të konsiderueshme bregdetare ,ku janë ndertuar deri tani disa resorte rezidenciale, në kryerjen e shërbimeve, është parashikuar dhe një popullsi shtese mund të shtohet gjatë sezonit veror ,pra popullsia e korrektuar e njesis Ishem është parashikuar me rreth 9.231 banorë rezident, të cilët shtohen edhe rreth 150.000 persona për çdo ditë në sezonin turistik Qershor – Gusht vecanërisht në zonën e bregdetit (vertetuar me vertetim të leshuar nga Njesia Administrative Ishem me nr. 1184/1 prot date 26.11.2020)

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Njesia Administrative Ishem.

Konteneret e mbledhjes së mbetjeve urbane do të vendosen në pikat që do të caktohen nga autoriteti kontraktore (sipas hartës treguese të bashkangjitur). Mbetjet urbane do të mbledhen dhe do të transportohen çdo ditë me anë të makinave të vena në dispozicion nga Operatori Ekonomik nën kontrollin e Drejtuesit Teknik të caktuar nga operatori.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pushlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 OE duhet të deklarojë se ka në stafin e tij punonjesis të kerkuar për kryerjen e shërbimit, të punësuar, e vërtetuar me listë pagesat për periudhën Maj 2021 si më poshtë:

- 1 Drejtues Teknik, me profesion Inxhinier Mjedisi, (Të jetë i pajisur me certifikatë lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis).për të cilin duhet të paraqesë:
 - Kontratë pune të vlefshme (përkatëse)
 - Diplomë
 - Libreze Pune
 - Te jete i pajisur me Certificate të Vlersimit të ndikimit në Mjedis dhe Auditim Mjedisor lëshuar nga Institucioni Shtetëror përkatës
- 3 (tre) shofer vërtetuar me kontratë pune të vlefshme të ndara si më poshtë:
 - 2 Shoferë kamionash të pajisur me Leje Drejtimi përkatëse për shofer kamioni dhe me Certificate Afësimi Profesional (ÇAP)
 - 1 Manovratorë (Eskavatoriste) të pajisur me Dëshmi Afësimi Profesional lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

-
- Një punësim i të paktën 11 (njembëdhjete) punonjësish krahu, si dhe të figurojnë të punësuar pranë shoqërisë shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme;
 - o Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj.
 - o Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- 2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- 2.2.2. Kopje të çertifikuara të bilanceve vjetore të paraqitura pranë autoriteteve tatimore perkatese për vitet financiare 2018, 2019, 2020, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.
- 2.2.3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020 (në rastin e bashkimit të Operatoreve Ekonomik duhet të paraqitet vërtetim për cdo OE).

Kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ato i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të Operatoreve Ekonomik dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

- 2.3.1. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.
 - Operatori ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me institucione shtetërore duhet të paraqesë kontrata të ngjashme për furnizime të shoqëruara me vërtetim realizimi nga institucioni perkates (enti publik) për kontratën e realizuar.
 - Operatori Ekonomik për të vërtetuar përvojën e mëparshme të realizuar me subjekte private duhet të paraqesë faturat tatimore të shitjes, ku të shihen datat, shumat, dhe sasitë e mallrave të furnizuara.
- 2.3.2. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Licence lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) :

Kategoria: SHËRBIME EKSPERTIZË DHE/OSE PROFESIONALE LIDHUR ME NDIKIMIN NË MJEDIS

Nën Kategoria: Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme

Kodi: III.2.B

- 2.3.3. Operatori ekonomik duhet të disponojë:

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 9001 – 2015** “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zerave që merr persiper të kryeje) ose ekuivalente.

- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 14001 – 2015** "Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit" lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO sipas zerave që merr persiper të kryeje) ose ekuivalente.
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **BS OHSAS 18001 – 2007 ose ISO 45001-2018**, për kushtet e sigurisë dhe të shëndetit të punonjesve, lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO sipas zerave që merr persiper të kryeje) ose ekuivalente.
- Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 39001 - 2012**, mbi sigurinë rrugore, lëshuar nga institucione të akredituara për ushtrimin e aktivitetit objekt i këtij prokurimi (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë certifikaten ISO sipas zerave që merr persiper të kryeje) ose ekuivalente.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të deshmojë se ka mjetet dhe pajisjet teknike për të kryer këto shërbime, si më poshtë:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Makinë teknologjike për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve me kapacitet mbajtës deri në 5 Ton (për kazane 1100 lt)	1 copë	Pronësi ose me qera
Makinë teknologjike për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve me kapacitet mbajtës 10 deri në 12 Ton (për kazane 1100 lt)	1 copë	Pronësi ose me qera
Makinë vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës 6 deri në 8 Ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome për ngarkim mbetjesh të inerteve	1 copë	Pronësi ose me qera
Kazan me kapacitet 1100 lt	220 copë	Pronësi ose me qera

- Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me dokumentacionin: Certificate Pronësie, Leje Qarkullimi, Kontroll Teknik, Sigurim, Taksat Vjetore, të vlefshme, si dhe të shoqëruar me foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*
- Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhenësit (original ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi) si dhe të shoqëruar nga dokumentacioni i plotë i çdo mjeti përkatës dhe foto të secilit mjet ku të jetë e dallueshme targa e mjetit dhe karakteristikat e tij.*
- Për kazanet e mbetjeve urbane OE në rastin pronësie duhet të paraqesë faturën e blerjes së tyre, ose në rastin e marrjes me qera të tyre të paraqitet kontrata e marrjes së kazanëve me qera e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi.*

2.3.5. Operatori ekonomik që paraqet ofertën duhet të disponojë një mjedis tërësisht në pronësi ose me qira brenda territorit administrativ të Bashkisë Durrës të paktën 1000 m² tërësisht për zhvillimin e këtij aktiviteti (në formën e kërkuar nga ligji, me certifikatë pronësie nëse është në pronësi, me kontratë qiraje pranë zyrës noteriale nëse është marrë me qera e shoqëruar me certifikatën e pronësisë të qiradhenësit). Operatori ekonomik në truallin në pronësi ose me qera duhet të disponojë një pompë me presion të lartë (pompë lavazhi) për larjen e makinerive si dhe për larjen e kazanëve. (në formën e kërkuar nga ligji, me faturë blerjeje, me kontratë qiraje pranë zyrës noteriale nëse është marrë me qera)

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar nëse është në gjuhën shqipe duhet të paraqitet në origjinal ose kopje e noterizuar e njësuar me origjinalin. Nëse dokumenti është në gjuhë të huaj, duhet të paraqitet i përkthyer nga një përkthyes i licensuar, shoqëruar me vërtetim përkthimi nga Noteri, si dhe i noterizuar e njësuar kopja me origjinalin nga Noteri.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar, ose paraqitja e dokumentave të rreme, përbën kusht për skualifikim.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Shërbimet /Mallrat e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:

<p>mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni:</p> <p>Adresën e ueb-it: [shkruajeni]</p> <p>Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni]</p> <p>Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

territorin e Republikës së Shqipërisë.	
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	_____
1. Kam lexuar dhe kuptuar	Po []

përmbajtjen e kësaj deklaratë;	
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që: a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës.	Po []
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve	Po [] Jo []

ekonomikë ose nën-kontraktimit).	
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me : a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	Po [] Jo []
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
